

SADULLA ZENDELI - DAJA
SHEKULLI I PAJTIMIT
KUJTIME, POEZI, PROZË, HISTORI

BOTIMET TOENA

SADULLA ZENDELI - DAJA

SHEKULLI I PAJTIMIT

kujtime, poezi, prozë, histori

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2019

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Recensent: Viron Kona

Redaktor: Kujtim Dashi

Korrektore letrare: Arlinda Rrushi

Përkujdesje grafike: Elsa Hajderaj

Kopertina: Mirjana Madhi

ISBN 978-9928-277-57-2

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

*Sa herë lëviz mbi akullin e detit Baltik,
mendoj të rrëshqas deri në Adriatik,
buzë vendit tim të lirë,
akullin duke e shkrirë.*



Sadulla Zendeli - Daja (83 vjeç)
Kalaja e Petrelës, 2014

PJESA E PARË
KUJTIME



Komuna e Nybros, pas tre muajsh punë, më pranoi si shef të bibliotekave të shkollave me punë të përhershme. Kështu u krijuan mundësitë që të punoja bashkë me familjet e tjera shqiptare për hapjen e shkollës shqipe...



Në foto, Muhamet Krasniqi.

Urime ditëlindjen, Dajë i nderuar!
Ju uroj jetë të gjatë, shëndet, shumë suksese e lumturi!
Ju uroj ditë të këndshme në ditëlindjen tuaj!

Muhamet Krasniqi

KUR I SHKROVA, DHIMBJET I SHËROVA

Si historia e një filmi rrjedh jeta mërgimtare. Në Suedi, shqiptarët erdhën që herët dhe, midis atyre të hershmëve, ishte edhe një nga shtyllat fuqিদhënëse të ruajtjes së identitetit kombëtar, Sadulla Zendeli - Daja. Ai dhe ardhja e tij bëjnë pjesë në episodet e filmit, si personazh i përndjekur nga vendi i tij, i persekutuar nga regjimi sllavo-komunist, për t'u bërë pastaj një nga aktorët më protagonistë që ende është pjesë e filmit të pakryer shumëpuntatshëm me konture mërgimtare, që do të ketë edhe shumë e shumë episode të tjera, tash e më optimiste.

Sadulla Zendeli - Daja, linguisti dhe shkrimtari, luftëtar i dijes dhe i arsimit shqip në trojet e Nordikës, themelues i shkollës shqipe



Daja, duke nënshkruar librin e tij.


në Nybro, në vitin 1975, dhe hartues i disa fjalorëve të njohur suedisht-shqip dhe shqip-suedisht, që deri tani kanë një volum prej rreth 91 mijë fjalësh. Njeri i dënuar nga regjimi jugosllav, të cilit, për 20 vjet rresht, nuk iu lejua kthimi në vendlindje pikërisht për shkak të veprimtarisë patriotike të tij në mërgim, ishte dhe mbetet ndër të fuqishmit atdhetarë e krijues, vazhdues i veprës së rilindësve tanë në shek. XX-XXI, model e burim frymëzimi në gjithë shqiptarinë...

SI LINDI NOFKA “DAJË”?

Në përgjithësi, shqiptarët, Sadulla Zendelin, e njohin me nofkën Daja. I lutem të na tregojë kah i erdhi kjo nofkë, dhe Daja, për herë të parë shpalos “sekretin” e këtij emri:

“Ishim një grup të rinjsh në Gostivar, që asokohe dëgjonim me ëndje radio ‘Kukësin’. Të dëgjoje atëherë haptas radio ‘Kukësin’, ishte e ndaluar nga regjimi. Por ne e bënim këtë vazhdimisht. Dhe, kur dilnim për të marrë vesh mes vedit se çka ka ndonjë të re nga radio ‘Kukësin’, ne i thoshim njëri-tjetrit, si në një dialog të koduar, që u kthye në ritualin tonë: ‘Si ishin nga Daja, a ishin mirë?’.

Një kujtim i përmalluar në radio “Kukësin”, të cilën, në kohën e regjimit komunist serb nuk na lejohej as ta dëgjonim.



Daja, në një vizitë te radio “Kukësi”.

Atë që dikur e ëndërroja dhe e dëshiroja aq shumë, më në fund, më 17 qershor të vitit 2016, arrita ta vizitoj... Ç'emotione më pushtuan?!... Në këtë moshë arrita të prek ëndrrën time?!

“Kur erdha në Suedi pata shkuar në një tubim të shqiptarëve në Zvicër. Aty, secili që paraqitej për të folur, kishte një tjetër emër, një nofkë, një pseudonim, sepse ishte tubim ilegal.

Kur dola unë, duhej të prezantohesha si gjithë të tjerët që merrnin fjalën. U thashë se quhem Sadulla Zendeli. Ishte pak e çuditshme për ta, që në një tubim ilegal të mos kishe një nofkë... Mendova, por ende s'e kisha përcaktuar konkretisht. Njëri, meqë isha më i vjetri ndër ta, m'u drejtua dhe më propozoi emrin Dajë, ndonëse ata nuk dinin asgjë për nofkën time të rinisë. Më pëlqeu dhe iu thashë se po prezantohem këtu me emrin, Daja, se kjo ishte, në fakt, edhe nofka ime. Dhe prej aty u krijua dhe emri im i ri, Daja, me të cilin prezantohem sot e më njohin shqiptarët që njoh.”

NË SHTËPINË E “SHQIPONJËS”

Kaluam urën e Ëlandit, që lidh Kalmarin me Ëlandin (6072 m e gjatë), ndërtuar mbi det dhe përruar qysh më 30 shtator 1992 nga mbreti Karl Gustaf XVI. Nën erën që frynte lehtas, karakteristike bregdetare, iu afruam shtëpisë së “**shqiponjës**”, shtëpisë që u bëri ballë edhe valëve të tërbuara të kohës, presioneve politike dhe kërcënimeve. Ishim, pra, në Färjestaden, në vendin ku me dekada flitet shqip e valon flamuri shqiptar, ku bashkë me “godmorgon”, thuhet edhe “mirëmëngjesi”, nën krahët e flamurit me shqiponjë...



Restoranti “Shqiponja” dhe qyteti i vogël suedez, Färjestaden, ku banon Daja.

“Urdhëroni një kafe!”, thotë duke buzëqeshur djali i Dajës në restorantin e tij “**Shqiponja**”. Shqiponja, e vendosur në hyrje, me krenarinë simbolike, tregon se këtu shqiptarët frymojnë dhe, pikërisht këtu, nën këtë kulm, u shkruan me mijëra fjalë e vargje shqip. Dhe, pikërisht këtu, gumëzhin midis detit, si zgjua bletësh, çerdhja nga dalin shkëndija drite dhe identiteti. Përshëndetja me Dajën nuk kalon pa ndjenja. Mirëseardhja lexohet në sytë e tij, të ofron ngrohtësinë dhe biseda rrjedh e hapur, ashtu sikur është natyra e tij fisnike.

“Mirë se erdhët dhe ju faleminderit!” shprehet me afërsinë dhe çiltërsinë e tij karakteristike, duke u ulur përballë meje, për të vazhduar bisedën.

Sado që isha nisur me bindje se do t’i bëja aq shumë pyetje Dajës, dështova. Ai, që në fjalët e para nuk la vend për protokoll, sepse temat rridhnin e vinin vetvetiu, ashtu siç ishte dhe është vetë jeta e Sadulla Zendelit - Dajës, autorit të fjalorit suedisht-shqip, që ishte doracaku i ABC-së për shqiptarët, që ua hapte portën për integrimet e tyre në shtetin me shkallë të lartë demokracie, në Suedinë nordike... Aty ku ai la gjurmë të mëdha në jetën mërgimtare.

DAJA ËSHTË METEORI

QË HAPI HORIZONTE DITURIE TE MËRGIMTARËT

“Eh, ishte rrugë e gjatë, e mundimshme, me rreziqe! Jemi regjur, Dajë”, më thotë. “Por isha i vendosur, frikën e lashë pas, më mirë të them se e mposhta atë, më së pari, brenda meje. Nganjëherë ndihesha edhe i vetmuar, apo vetëm me djalin tim, Ismetin, kur përshkonim kilometra të tërë deri në Stokholm, në të mirë të çështjes shqiptare, vetëm që të ishim pjesë e pandarë e karvanit atdhetar.

“Në Stokholm, herë shkonim vetë, herë na shoqëronte edhe Xhemal Duraku me Shehiden dhe Xhelal Ademi me Hasijen, herë ndonjë tjetër. Shpesh na bashkëngjiteshin apo iu bashkëngjiteshim shqiptarëve të Malmös, se atje do të protestonim, do të ngrinim zërin për lirinë dhe shqiptarët, sidomos në përkrahje të UÇK-së, dhe duket sikur e ndjenë se kishin nevojë për më tepër përkrahës e bashkëveprimtarë, ani që thotë ai, në tërësi nuk ishim të paktë.”

Me daljen e tij me shumë mërgimtarë nga Suedia, Daja bënte udhëtime edhe nëpër shtete të ndryshme të Europës. “Shumë herë lidheshim me mërgimtarët tanë në Bremen të Gjermanisë. Aty na priste aktivisti i shquar për çështje kombëtare, Zulbehar Beshiri me gruan dhe vajzën e tij, studente e gjuhës gjermane, Ismijen, në kohën kur Kosovës i duhej më së shumti zëri mërgimtar në ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare.”

FORMIMI I SHOQATËS “ILIRIDA”

Ka shumë kapituj përmbajtjesorë e të pashkruar ende, romani autokton, patriotik e kulturor i quajtur “DAJË”, por shkolla shqipe dhe nevoja për arsimimin e fëmijëve mërgimtarë në gjuhën amtare sikur janë pikënisja... zanafilla...

“Erdha në mërgim, po si të flija i qetë?! S’isha thjesht një mërgimtar me një numër në gjoks! Ç’të bëja për kombin tim? Isha mësues dhe mësuesia nuk është thjesht një detyrë, por një mision i lartë fisnik e iluminist, kudo që të jetë mësuesi, kudo ku ta përplasnin dallgët e jetës. Andaj, bëra çmos të hapja tunele drite për të bërë të pamundurën, që fëmijët tanë të mos e harrojnë gjuhën mëmë, të mos i presin rrënjët e njoma me atdheun.”



Sadulla Zendeli - Daja në qytetin suedez Nybro, në një nga takimet me bashkatdhetarët shqiptarë.

Daja, në ato vite djaloshare, që në hapin e parë, në tokën suedeze, ishte frymëzuar e pajisur me dije nga qyteti i njohur universitar, Uppsala, ku ai studioi në shkencat filologjike-filozofike dhe tashti e kishte bagazhin kulturor, atdhetar, përvojën arsimore-suedeze, dashurinë dhe guximin, për të qëndruar fort në “istikamin” e vet dritëdhënës: të hapte shkollën shqipe, të hartonte fjalorë gjuhe e gramatike, se këto u duheshin urgjentisht /imediatisht si ushqimi i përditshëm bashkëkombësve...



Pamje nga qyteti Nybro, Suedi.

Shkolla e parë shqipe në Suedi u hap në Nybro, falë kurajës së përballjes, falë kontributit të guximshëm e të palodhshëm të Sadulla Zendelit - Dajës, si dhe mërgimtarëve të tjerë. Ishte viti 1975.

PO SI FILLOI?

Sadulla Zendeli-Daja edhe sot, kur tregon për ato kohë, thotë se sikur e ka përpara syve gjithë atë skenar të orkestruar nga ambasada e atëhershme e Jugosllavisë për pengimin e aktiviteteve kulturore dhe pengimin e hapjes së shkollës shqipe.

“Tani, kur e tregojmë si histori, duket e lehtë, pa peripecitë, shovinizmat, arbitraritetin, pa kthetrat e hegjemonisë shtetërore

që shtriheshin kudo, si ndaj një populli të pushtuar edhe në Suedi, djallëzitetë, me të cilat u përballëm hap pas hapi, ndaj nuk ishte aspak e lehtë, fare nuk ishte e lehtë. Të rinjtë shqiptarë ishin të përfshirë në kuadër të shoqatës kulturore serbe

‘Vuk Karaxhiq’, shumë edhe të detyruar. Dhe, ne që donim të zhvillonim kulturën, këngën e vallet tona shqiptare, hasnim në pengesa nga më të ndryshmet. Suedezëve, në anën tjetër, u duhej sqaruar mirë, se ne nuk ishim jugosllavë, siç na pyesnin shpesh, por se ishim shqiptarë, etni krejt tjetër dhe autoktonë në vendin tonë. Na pyesnin për dallimet gjuhësore. U shpjegoja se aq sa kanë ngjashmëri suedishtja e rusishtja, po aq kanë ngjashmëri edhe shqipja e serbishtja. Nuk dinin shumë për shqipen e Shqipërinë.

‘Ishte një program kulturor kur bëmë shkëputjen e parë, në maj të vitit 1975. Atëherë dolëm nga programi që kishte bërë shoqata ‘Vuk Karaxhiq’. Ishte shumë e vështirë, por të rinjve shqiptarë iu duhej një shkëndijë, një nxitje, një fillim i ri, një përkrahje, dhe unë ua dhashë atë mbështetje, pa asnjë rezervë, me shumë dashuri. Isha unë ai që i nxitja dhe pas meje e lëshuan sallën...



Daja me prindërit dhe nxënësit e shkollës shqipe në Nybro, Suedi, 2001.

“Por jo edhe aq vështirë, ndoshta, shpirti i tyre ishte aty, ishin njerëz të revolucionit, njerëz që e donin lirinë, që s’mund t’i bartnin

me vete në një shtet demokratik si Suedia, prangat e pushtuesit, ‘bashkim-vëllazërim’. Atyre u duhej vetëm një shkëndijë, dhe ishte fati im që të isha nxitësi i tyre.

“Qeshë vërtet i guximshëm kur ambasadorit jugosllav i pata thënë se, “për shkak të nacionalizmit serb e jugosllav, keni arritur të na i merrni e mohoni edhe kulturën e traditën tonë. Unë nuk dua të jem në këtë grup nationalist, se kurrë nuk dua të jem në atë shoqatën, ‘Vuk Karaxhiq’, u shpreha në shqip, suedisht dhe serbisht.

“Ishte një konfrontim i ashpër dhe i hapur, në pikën e vlimit, ku s’mban më, si i thonë një fjale; u kam thënë gjithçka që mund të thuhej e kështu m’u duk se fola në emër të popullit tim, të historisë së tij; iu citova At Gjergj Fishtën, është njëri nga poetët tanë kombëtarë, i cili thoshte se, ‘kur sllavët kishin zbritur nga Uralet e Siberisë, populli ynë autokton e kishte kryer ciklin dymijëvjeçar të qytetërimit; se në rrënjët tona zë fill qytetërimi europian dhe se jemi ndër popujt më të vjetër të kontinentit tonë’.

“Shqiptarëve, ndërkaq, u thashë se jam në mbrojtje të shtetit suedez. Pastaj dola, u ula jashtë, e kapa kokën dhe mendoja: ‘O Dajë, qysh bëra, me i marrë në qafë vëllezërit, pse fola?!’.

“Por, këtu zuri fill Shoqata Kulturore shqiptare, ‘Ilirida’.

“Forcën shpirtërore dhe atdhetare e kisha vetë. Ambasada jugosllave më thirri pas tetë ditësh në telefon dhe më kumtuan se më kishin dënuar, që për 20 vjet të mos hyja në vendin tim.

“Në Nybro u mund ambasada jugosllave. Ata, madje, edhe na ishin lutur e bërë presion që restoranti ynë të mos mbante emrin ‘**Shqiponja**’, se do të ishte emër e qendër për separatistët nacionalistë shqiptarë, por nuk patën sukses, se ne s’i dëgjuam dhe shqiponja valon sot e asaj dite...”

FILLIMI I SHKOLLËS SHQIPE

Ditën e parë kur kam ardhur në Nybro, shkova në bibliotekën popullore dhe u takova me drejtuesin e bibliotekës. Ai më tha se

qyteti i Nybros kishte rreth 10-15 familje shqiptare dhe më nxiti që të punoja edhe në bibliotekën popullore të qytetit. Vendimin e kisha marrë nga Komuna e Nybros, i punësuar për një kohë të caktuar, përgjegjës për bibliotekat e shkollave në Nybro me rrethina. Zyrën e kisha në bibliotekën e shkollës së mesme “Åkrahällskolan”. Fillova punën me kontratë për një kohë prej gjashtë muajsh, ashtuquajtur “Vikarijat”. Unë kisha mbaruar edhe shkollën e lartë dyvjeçare për bibliotekist, dega universitare dhe e sipërmarrjeve në qytetin Borås (Boros).

Në punën time, pas tre muajve, Komuna e Nybros më pranoi me punë të përhershme si përgjegjës i bibliotekave të shkollave. Gjithashtu, m’u krijuan mundësitë që të punoja bashkë me familjet e tjera shqiptare për hapjen e shkollës shqipe. Një nismë e bukur dhe fisnike.

Dajës i kujtohen shumë fakte e detaje rreth asaj kohe dhe këto na i rrëfen me një kronologji mbamendëse që të habit, sikur

i kanë ndodhur dje dhe koha i kishte konservuar aq mirë në memorien e tij. Megjithatë, ne po shkëpusim ndonjë fragment, edhe pse secili tregim është interesant dhe, siç thamë në krye të herës, ngjajnë si seritë e një filmi në proces, ose i papërfunduar ende.



Daja, në një nga gazetat e njohura suedeze. (Dëshmi për hapjen e shkollës së parë shqipe në Suedi, 5 mars 1975.)

Bibliotekisti ambicioz ligjëron edhe në gjuhën shqipe. Emri: Sadulla Zendeli. Ai ka pasaportë jugosllave, por i përket grupit të etnisë së gjuhës shqipe në Jugosllavi. Në Jugosllavi, Zendeli ishte

ekonomist dhe kontabilist. Në Suedi, studioi në Universitetin Uppsala (Fakulteti Filozofik) që nga viti 1967. Pas diplomimit në këtë Universitet, vazhdoi studimet në shkollën e lartë për bibliotekist, drejtimi Universitar dhe i Sipërmarrjeve në Borås.

U punësua katër orë në javë si mësues i gjuhës shqipe për fëmijët shqiptarë në komunën Nybro, me 8 nxënës. Në sesionin e dytë numri i nxënësve u rrit deri në 15.

Një zyrtar i komunës më telefonoi për të më pyetur nëse dinin fëmijët shqiptarë shqip.

Është interesante biseda e bërë me nxënësit, kur të pranishëm ishin 4 rektorët e shkollave dhe kryetari i seksionit të arsimit për komunën e Nybros, si dhe një arsimtar serb, i cili përpiquej të kundërshtonte dhe ndalonte hapjen e shkollës shqipe, rrëfen Daja.

Në prani të zyrtarëve, rektorëve suedezë, mësuesi serb nisi të pyeste një nga nxënësit shqiptarë:

- Kakosi lepi decko (deçko)? (*Si je ti djali, mirë?*)

- Vet inte (*nuk e di*), - ia ktheu nxënësi shqiptar në suedisht.

Pyeti edhe një vajzë dhe një djalë tjetër. Edhe ata iu përgjigjën suedisht:

- Vet inte (*nuk e di*).

Këta kanë një dialekt të Serbisë së Jugut, e për këtë nuk e marrin aq shumë vesh serbishten, u përpoq t'i bindte djallëzisht zyrtarët suedezë mësuesi serb, domethënë t'i mashtronte sheshit, duke sajuar, gjoja si alibi, një dialekt serb në jug të Serbisë. E kundërta ndodhi në të vërtetë. Suedezët u bindën se fëmijët s'donin të flisnin serbisht. Më thanë se ti do t'u flasësh shqip fëmijëve, i kujtohet Dajës.

Fëmijëve iu tregova se unë jam shqiptar dhe flas shqip dhe se nëna ime e ka emrin Kadime, babai, Sulë Gurra, e baba Adil Zhuta, axha Isen, Qenan, Ramiz etj. Ne jemi shqiptarë, kemi Flamurin tonë kuqezi me shqiponjën dhe emblemën e Skënderbeut. Megjithëse u ndjeva ngushtë, e fitova luftën në raport me tentativat e ambasadës jugosllave. Kam pasur shumë emocione, i kam edhe sot, sa herë që e sjell ndërmend këtë skenë, - thotë mësuesi Sadulla dhe vazhdon:

Suedezi i tha serbit duke ia bërë me gisht: "Från och med imorgon vill jag inte at albanskabarn i din klass (*Që nga nesër nuk*

dua t'i shohë fëmijët shqiptarë në klasën tënde!). Mua më tha: “Që nga nesër do t’u mësosh fëmijët shqiptarë, dy orë në javë, gjuhën amtare, shqipe”.

Dhe këtu filloi shkolla shqipe, e themeluar më 5 mars të vitit 1975. Kjo është një datë e shënuar në analet e arsimit shqip në mërgatën shqiptare!

ZILJA

Më 2006, qe shënuar 30-vjetori i shkollës së parë shqipe në qytetin e Nybros, Emmabodës dhe Kalmarit të krahinës së Smolandit të Suedisë me një solemnitet madhështor. Organizimin e pati organizuar Shoqata Kulturore shqiptare “Ilirida” e Nybros. Dhe qe një festë gëzimesh, emocionesh e suksesi. Një moment kujtohet nga gjithë pjesëmarrësit, qëedhe sot kur e kujton Daja, është diçka e rrallë, përjetim i veçantë.



Daja, për befasinë e qindra pjesëmarrësve, pati nxjerrë nga çanta një zile duke e tringëlluar për një çast. Salla e mbushur me mysafirë do të kumbonte nga tringëllima e saj, si pjesë e simfonisë së shkollave dhe kudo nëpër botë ku flitej gjuha e bukur shqipe e fituar dhe këtu në Suedi me sakrifica jo të pakta, me vullnet e këmbëngulje të madhe.

“Me këtë zile, për 30 vjet rresht i kam ftuar nxënësit e mi në mësimin e gjuhës shqipe”, u pati thënë të pranishmëve mësuesi Sadulla Zendeli - Daja. Dhe tani, kur e kam përballë në bisedë, sikur e shoh duke e tringëlluar si relikte historike, që ia dhuroi mësuesit, Raif Mehmeti, sepse duhej vazhduar tradita, duhej të tringëllonte përherë atyre anëve...

FJALORI SUEDISHT-SHQIP

Asgjë s' ishte e lehtë. Por nganjëherë jeta dhe nevojat të bëjnë të fortë, të mençur dhe të orientojnë në momentin e duhur drejt të nevojshmes e të domosdoshmes. Daja thotë se gjërat ishin më shumë spontane, por të suksesshme. Shqiptarët në Nybro fituan përkrahjen edhe në seksionet suedeze të arsimit, fituan përkrahjen edhe për nevojën e hartimit të fjalorit suedisht-shqip, sepse u duhej bashkëkombësve.

“Ishte vështirë të kundërshtojë një shtet siç ishte Jugosllavia, - thotë Sadulla Zendeli, - por e arritëm, ia dolëm mbanë e me sukses. Formuam shkollën shqipe, shoqatën shqiptare. Bëmë fjalorin suedisht-shqip. Atëherë, një grup arsimtarësh nga Smolandi shkuam në Skolverket.

“Unë s'kisha shtet, se Jugosllavinë s'e njihja shtet, por shkova te shteti shqiptar, kurse autoriteteve suedeze iu thashë se kisha parë shumë raftë librash, por jo me libra shqip. Suedia na ka përkrahur në vazhdimësi dhe për këtë u jemi shumë mirënjohës, shumë mirënjohës për mbështetjen e tyre pa rezerva.

“Kjo që bëra unë nuk ishte një planifikim. Unë vetëm kam parë një mjegull të madhe, e në të një dritë, u thashë se ajo ishte drita e shqiptarëve. Dhe ashtu ishte. Mendoja se detyra e secilit intelektual është të ndihmojnë shqiptarët në mërgim.”

DITARI I DHIMBJEVE: SI I KËRKOVA EDHE TETË MUAJ JETË...

Sadulla Zendeli - Daja, është simboli i njeriut të qëndresës. Më tregon se kohë më parë i ishte nënshtruar një operacioni të rëndë të zemrës. Por, ajo që më la përshtypje, ishte lutja “e çuditshme”, që Daja u kishte bërë mjekëve para se të hynte në operacion.

- Ju lutem, a mundeni të ma zgjasni jetën për tetë muaj?!

- Pse? - e kishin pyetur mjekët.

- Sepse dua ta përfundoj *Fjalorin shqip-suedisht*, që pothuajse e kam gati, - iu kishte thënë Daja.

- *Konstigt* (e çuditshme)! - ishin shprehur mjekët.



Botime të librave dhe fjalorëve të Dajës ndër vite.

Por, pas operacionit, mjeku i kishte thënë:

“Tash e tutje, besoj se do të shkruash edhe dhjetë fjalorë të tjerë...”

Vërtet i shkrova katër libra. Dy u botuan e dy janë në proces botimi.

“Nuk jam poet, - thotë Daja, - por i kisha do dhimbje dhe i shkrova. Se një shkrimtar i madh ka thënë: ‘Krijimi ecën mbi dy shina: mbi dhimbjen dhe dashurinë’. E shkrova ‘Ditarin e dhimbjeve’. E, kur i shkrova dhimbjet e mia, atëbotë u shërova!”

“Ditari i dhimbjeve” është shpirti atdhedashës i autorit, është vetë Sadulla Zendeli - Daja, me zemrën e tij të lënduar, me dashurinë dhe vuajtjen, me dhimbjen dhe qëndresën, është jeta mërgimtare dhe dashuria atdhetare...

Shpirti i tij krijues dhe atdhetar bëri që ta zgjedhë Ëlandin si vend për të jetuar, si vend që do t’i sillte frymëzime...

Ëlandin, më tepër e kam zgjedhur si një ujdhesë shqiptare, se kështu e paramendoja. Edhe Herliga Birgita (Shenjtorja Birgita), e ka bustin këtu. Kur ajo shkoi në Itali, e gjeti një ujdhesë si Ëlandin. Ajo ndërroi jetë dhe e sollën në Suedi.



Pamje nga ura dhe deti Baltik.

I pata thënë vetes se do të shkoja në një ujdhesë, te Deti Baltik i madh, sigurisht edhe një pikë e këtij deti do të mund të përngjasojë me Detin Adriatik. Kjo ishte ujdhesa ime e Shqipërisë, e mendova kështu dhe këtu më lindën shumë frymëzime... Këtu është edhe shtëpia verore “mbretërore”, - shprehet Daja.

VRULLI I ATDHEDASHURISË

“Unë s’kam qenë më trimi. Të them se kam pas fat, s’mund të them. Një i mençur thotë: ‘Fati është një çast, jeta është pjesa tjetër’”.

Ndërsa Siddhārtha Gautama Buda thoshte: “Mijëra qirinj mund të ndizen nga njëri dhe jeta e këtyre qirinjve nuk do të zvogëlohet. Kështu edhe fati, kurrë nuk zvogëlohet kur ndahet me të tjerët”, shtova unë si për të përforcuar idenë e bukur e interesante që vuri në spikamë Daja. Por unë e kam parë dritën time dhe dritën mes mjegullës, se shqiptarët kështu duhet të jenë. Frymëzimi im i madh: çdo hap që bëja, mendoja se po bëja një hap për gjithë kombin tim. Ky ishte ai inspirimi e vrulli i atdhedashurisë...

Pata ardhur këtu për një kohë të shkurtër, por rrethanat e jetës më bënë të jem ai që jam sot. Mua më shtyu jeta e mërgimtarëve, unë do të shkoj prej këtu, por do të mbetem ai tjetri, se i kisha 45 mijë shqiptarë pas vetes... Prandaj është “Ditari i dhimbjeve”, se jeta e bën të veten.



Pamje nga Sërmmova, vendlindja e Dajës.

Për pak çaste, Daja hesht. E shikoj me admirim. Vazhdon, ashtu si edhe jeta e tij.

Kjo më bëri që pas 75 vitesh jetë, të shkoj në Sërmnovë të Gostivarit, të blej një truall të xhaxhait tim dhe të kthehem atje. Jam i pari që kam ngritur dhe kam bërë varrin tim në vendin tim. Të gjithë janë habitur! Edhe vjershat i kam shkruar për vendin tim.

Dua të varrosem pranë lisit tim, të trashëgimisë sime.

Daja, Sadulla Zendeli, ndoshta edhe bën rezonimin më të sinqertë prej mërgimtari: “Unë u asimilova, ani që kam qenë kaq i zjarrtë, unë jo, djemtë e mi jo, po familja ime u asimilua...”

Desha që atë asimilimin tim ta varros atje, prandaj e bëra varrin tim, t’iu them atyre se unë jam këtu... Dhe pas këtij vendimi, fëmijët e mi më kanë përkrahur. Djali i dytë, Agimi, më thotë: “Babi do të shkoj atje...”.

I shtroj një pyetje për integrimin Dajës.

“Ne jemi të integruar qind për qind për disa herë. Po të mos ishte Suedia, unë s’do të arrija këtu ku jam, rezultati do të ishte tjetër”, vë në spikamë ai.

Daja ka tre djem, një vajzë, 7 nipa dhe 1 mbesë, që janë me shkollë të mesme, ndërkaq stërmbesa është magjistruar dhe vajza ka përfunduar masterin për kriminalistikë në Suedi.

Shtëpia e Dajës në Färjestaden nuk është vetëm shtëpi e flamurit dhe e shqiponjës, ajo është dhe një bibliotekë e pasur, një shtëpi botuese dhe një shtëpi dritëdhënëse në ujdhesë, një portë e hapur për shqiptarinë...

PO CILI ËSHTË MËRGIMTARI?

Ai mendohet, merr frymë thellë dhe thotë:

“Mërgimtar? Një njeri që gjithmonë është fizikisht në kalvarin e mërgimit me plot të papritura e sfida që do t’i përballosh me shpirt e zemër në atdhe, me trup në mërgim! Një dyzim të tillë vetëm mërgimtari e ka, si Anteu që nuk ecën mbi dheun e vet. Je gjysma e qenies tënde, e përsërit Daja, duke e shoqëruar me një psherëtimë të kahmoçme e aq shpesh të përsëritur ndër mote... E, mërgimi është i dhimbshëm, shumë i dhimbshëm!”, thekson me një krenari modeste që, megjithatë, ia ka mbërritur për t’ia dalë mbanë.

ËNDRRA IME...

Takimi i parë me Suedinë, për Dajën ishte edhe takimi e sinjali se ëndrra e tij për arsimim dhe lirinë e popullit do të realizohet. Kur e pyes se a u realizua ëndrra e tij, Daja kthehet në fillim të shtegtimit të tij në kurbet:



“Eh, ta dish, Dajë, kjo më bën sot të lumtur! Që ditën që kam dalë në Universitetin e Uppsalës dhe kam parë lirinë, rendin, urtësinë në këtë shtet skandinav, i thashë vetes: ‘Kjo ishte drita ime, të ndihmoj popullin tim dhe ky vend më frymëzon!’ ,më përgjigjet ish-studenti i Uppsalës, Sadulla Zendeli, i cili ka autoritet të madh te suedezët. Ai i është shumë mirënjohës shtetit suedez për përkrahjen e dhënë shqiptarëve, për mundësinë e shkollimit e të ngritjes kulturore...

“Kur hyn thellë në shpirtin suedez, ata të japin forcë, ide, qëndresë... Nëse hyn në shpirtin suedez, gjen gjëra shumë të mira, kemi edhe ne shqiptarët gjëra shumë të mira dhe këtu ndodh pikëtakimi ynë, substrati i popujve, pavarësisht se në ç’territore e sisteme jetojnë. Po të mos ishte Suedia, unë s’do të arrija këto

rezultate”, thotë njeriu që kam përballë në tavolinë, intelektual i dhe pedagogu, Sadulla Zendeli-Daja.



Daja në studion e tij, Ujdhesë, Färjestaden.

Mediat suedeze të kohës i kanë kushtuar faqe të tëra aktivitetit liridashës, arsimor e kulturor të Sadulla Zendelit - Dajës. E quajtn bibliotekist shkollor ambicioz, e çmuan atë se në projektet e tij kombinonte shpirtin dhe zemrën, pasionin e pashuar për dijen, siç ishte rasti me fjalorin, e përshkruanin tavolinën me portretin e kryeministrit suedez të kohës, Olof Palme, që nderohej në shtëpinë e Dajës në Färjestaden dhe shpesh përshkruanin historikun e dhembshëm të dëbimit të shqiptarëve nga atdheu, midis të cilëve, ishte i detyruar të merrte rrugët e mërgimit edhe Sadulla Zendeli - Daja.

Ato shkrime, Daja sot i ruan me fanatizëm si relikte të çmuara që s’i përkasin vetëm vetes, por tashmë dhe historisë së mërgatës shqiptare në tërësi e të asaj në Suedi në veçanti...

“Është kjo pasqyrë e kronikës së jetës sonë, e punës sonë”, thotë ai.

Bëjmë edhe pak shëtitje afër bregdetit. Sadullai, në një çast merr frymë, plot emocione, ia lëshon një sy bregdetit suedez, aty ku edhe u burrërua dhe ku shpesh gjeti brumin e inspirimit

krijues. Bëmë edhe fotografi bashkë. Ai nuk e harron traditën. Ua fal gramatikat shqipe, autor i të cilave është vetë, disa nxënësve mysafirë nga Gjermania dhe nga Suedia, të cilët i takon përziemërsisht afër bregdetit... Me ta bën fotografi.

“Këta kanë nevojë, këtyre u duhet libri dhe dija, - thotë Daja. - Këta do ta ruajnë e kultivojnë traditën dhe identitetin tonë, pra brezi i ri, ky që vjen”, thotë Daja, dhe si djalosh i ri, sikur në vrap vazhdon ecjen...



*Ullmar Qvick (Kvik)
Albanolog, poet, përkthyes.
Miku i madh i shqiptarëve.*

URIMET E MIA PËR DITËLINDJEN E DAJËS

Me trup të vogël dhe me shpirt të madh, me mendje gazmore dhe qëndrim optimist, njeri modest dhe shumë punëtor, janë veti që unë kam gjetur te Daja. Ai nuk merret me spekulime, por disa herë hyn në aventura gjuhësore! Vetëm me shpirt djaloshtar njeriu guxon të merret me botimin e fjalorëve. Dihet se puna jonë kulturore nuk do të shpërblehet gjatë jetës sonë. Prapëseprapë, vlera e punës së kryer kulturore do të mbetet.

Daja është njeri përparimtar me vetitë më të mira shqiptare, harmonizon frymën e demokracisë dhe të shoqërisë moderne, veti tradicionale suedeze. Dashuria për atdheun, për shqiptarinë nuk e ka lënë mikun tonë rehat asnjëherë. Ai punon, udhëton, ideon e planifikon.



*Ullmar Qvick (Kvik) dhe Sadulla Zendeli - Daja,
Boros, Suedi, prill 2012.*

Urimet e mia më të ngrohta për përvjetorin e mikut, Sadulla Zendeli! Në bashkëpunim, Daja tregon një modesti dhe frymë konstruktive të pashembullt. Ai nuk dorëzohet përpara vështirësive, është i paepur.

Mund të shkruaja shumë faqe për këtë mik të singertë, por me këto rreshta kam dëshirë vetëm të shpreh respektin dhe solidaritetin njerëzor që ndiej për Dajën, pas shumë vitesh kontakte miqësore.

Urimet e mia për ditëlindjen e Dajës, më mirë po i shpreh në gjuhën time amtare: “Ja mådu leva, ja mådu leva i hundradeår!” (Një gjë dihet: vepra e Dajës do të rrojë në dobi të shqiptarëve kudo ku ndodhen!) Nderi i tij dhe emri i mirë do të ruhen në historinë e kulturës shqipe.



Agim Gashi, rapsod.

KENGË KUSHTUAR 83-VJETORIT TË DITËLINDJES SË SADULLA ZENDELI - DAJËS

Gjithë shqiptarët mërgimtarë,
Nga vendlindja ruajnë kujtime,
Kudo shkojnë e marrin me vete.
Një grusht atdhe nga toka ime,
Sot jehojnë fusha e male,
Lume shqipja kënd ka djalë!

Moj Sërmnovë, moj zemra e Sharrit,
Linde legjendën e Gostivarit,
Si shqiponja n'fluturim,
Me mbrojt gjuhën e popullit tim.
Nuk kursen djersë a jetën,
Për me thënë gjithmonë t'vërtetën.

Ku të kam, o burrë me nam,
Për ty ndien atdheu amë,
Librat tuaj për lakmi,
Pasuni për Nanën Shqipni.
Pena jote kurrë nuk ndalet,
Sot shqiptarit i zbut hallet.

Prej vendlindjes kemi një emër,
Ne të gjithë të mbajmë në zemër,
Të mbajnë nipat edhe mbesat,
Vepra jote ka bâ kthesa.
Sadulla, shqiponjë e Sharrit,
Rojë e trimit, Xhemë Gostivarit.

Në mërgim ti kot nuk shkove,
Në fakultete shumë studiove,
Fjalorët e gjuhës për njohuri,
Për suedezë e shqiptari.
Sadulla i klinton n'brumë,
Vajton atdheun e cungum'.

Populli im qofsh i bekuar,
Qazim Sula t'ka thur një këngë,
Për Dajën, burrin hijerëndë,
Viron Kona e dha sinjalin:
Asht një burrë nga trojet tona,
Ndez për të gjithmonë jehona.

Zendel Daja, drita e kombit,
Rrezaton rreth e qark globit,
Këngë e gëzim marrin dhenë,
Kur shkruan Daja për Skënderbenë,
Për atdhe dhe dritë lirie,
Krenari për tok' Arbërie.

O Sadulla Zendeli - Daja,
Në atë vrull po sikur lumi,
Ëndrra jote shumëvjeçare,
Në Arbëri me kalë t'pruni,
Ty njeri me shpirt të mirë,
T'plotësoftë Zoti çdo dëshirë!

Lum nëna, vëlla, që të lindi,
Lum atdheu që të rriti,
Ai djep që ty të përkundi,
Shpërndan shqip nderin për jetë,
N'vazhdimësi brezave amanet.


Miqtë e tu nuk të harrojnë,
Këngë e vargje të kushtojnë,
T'këndojnë me krenari,
Lum Atdheu që të ka ty,
Iliridës i solle ti,
Plot Kosovë e plot Shqipni.

Sot Kosova dhe Shqipëria,
Ilirida dhe Çamëria,
Trojet tona të gjitha mbarë,
Preshevë, Vlorë e Gostivar,
Të urojmë shëndet e jetë,
T'na jetosh edhe njëqind vjet!

Ti o Dajë, o Lulja e Sharrit,
O stërnip i Xhem Gostivarit,
Besë, burrni e njerëzi n'jetë,
Na i le ti amanet;
Emri yt na është mirësia,
Me ty krenohet Shqipëria, o hej!

*Shënim: Kënga mund të dëgjohet në YouTube, thjesht duke klikuar emrin
Sadulla Zendeli - Daja.*

PJESA E DYTË
POEZI



Portret i Dajës.

*“Sa herë notoj nën akullin e detit Baltik,
mendoj të rrëshqas deri në Adriatik,
buzë vendit tim të lirë,
akullin duke e shkrirë”.*

GËZUAR KRISHTLINDJETDHE VITIN E RI 2018!

(Daja, 83 vjeç)

Nesër, patjetër do t'i shkruaj urimet e mia
Me zemrën time...
O, tungjatjeta dhe veç urime!
Me engjëjt jam këshilluar,
Në dialog gjithë jetën
Me ua treguar,
Përherë m'kanë bekuar:
Shkruaj dhe mos u ndal
Do të vijë ajo ditë e shenjtë,
Bashkimin e shqiptarëve
Jo askush dot s'mund ta ndërpresë

Efendijtë e haxhillëkut,
Dhe neootomanët e fudullëkut,
Nostalgjikë shpirtzbraztë,
Le t'luten e le t'falen,
Kusuret t'u falen,
Kur do t'flakin havalenë
Duke ngrënë bakllava, fli e pilaf,
E kombin mos ta marrin në qafë.

Me Bajram e me Pashkë,
Shqipërinë e kemi dhe e bëjmë bashkë.
Kryefjalë e të madhit, Fishtë
Kur hoxha e prifti
Faleshin së bashku në livadh.
Mjaft bash na keni trazuar,
Duam të jetojmë në harmoni
Me njëri-tjetrin grushtbashkuar.
Sekush të jetojë në liri,
Besimin ta zgjedhë siç do vetë
Mos na impononi më dogma fetare,
Se feja jonë është Europa
E jo përçarja me dogma...
Njëzëri themi; feja jonë është Europa
E jo theqafje t' historisë me gropa...

MEDITIMET E POETIT

Kujtesa e një poeti
Ndrin si qielli me yje,
Muzat e çasti fatlumë
Sikur marrin rreze në lumë.
Rrezet e diellit i ngrohin
Ëmbël i përkëdhelin dhe i jetësojnë.
Kur para pasqyrës krihen
Seç këndojnë dhe për larg nxitojnë,
Të çajnë shtigjeve të jetës.

Aureola e poezisë, sa m'ngjan,
Me femrën e bukur
Kur shtrihet në lëndinë,
Ku yjet dhe dielli trupin ia përpijnë
Me ledhatime e ëmbëlsi...

Dhe ia rritin dëshirën për jetë,
Dhe e bëjnë më të shndritshme.

Fqinjët më shikojnë çuditshëm
Ej, zotëri, ç'ka po bën?
Udhëve, duke ecur, u them
Drejt Shtëpisë së Perëndisë.
Nisur jam drejt përjetësisë,
Asgjë nuk më ndalon
Akrepat e jetës lëvizin
Dhe numërojnë vitet e mia
E unë s'di kah po shkoj
Dhe kur do të mbërrij...

Pamundësia rri strukur
Në kufijtë e dëshpërimit, hidhërimit,
Engjëjve u thinjen flokët
Si në stinët e Vivaldit.
Kur poeti ta rrëfen të tijën jetë...
Sa të ndih të kuptosh të vërtetën
E nëse s'mendon mirë, mor mik,
Mos u habit kur mund të zhytesh
Pakuptuar e befas në t'ligun rrezik!

Në honet e ndjenjave të poetit,
Bën mirë e thellë të reflektosh
Se ndodh t'theqafesh në humnerë
E nga andej s'del më dot,
E mund të mbytesh, në të tuat lot

Jeta ka qëllimet e veta
Të mbrohta e të vërteta,
Ta lulëzosh duke mugulluar
Dashurinë duke e kultivuar,
Hyjnorja që të jep fuqi,
Për të vajtur i qetë
Në botën e pasosur të Përjetësisë...

ME KAPUÇ TË BARDHË

Vetëm neve na zbardh ky margaritar,
Burrëri me të i jep çdo shqiptari,
Rrënjështat mori n'lashtësi
Vetë Zeusi, kur me Perëndeshë, Heren, vuri kurorë,
Gravura flet, se qeleshen tonë pati simbol...

E kem simbol për burrëri
Me pellazgë, ilir e n'shqiptari,
Emblemë e patëm përmbi ballë,
Me të betejave u rreshtuam
Legjenda të shumta u krijuan.

Me plis a me kapuç borë të bardhë
Mahnitëm botën mbarë,
Me plisin borë t'bardhë shqiptar,
Rrënjëthellas n'kët' tokë, më i parë,
Ç'lumturi, që jam shqiptar!

Plisi i bardhë është hyjnor,
Me të ranë shumë dëshmorë.
Barbarët duan ta tjetërsojnë,
E ngjyrosin herë të kuqe a të zezë.
Jo, jo, ai ndrit borë i bardhë.

Plisin, Zoti, neve na e ka falë,
Dhe ia hodhëm lart mbi t' lartin ballë,
Bill Klintonit, që na adhuron,
Sa bukur plisi në kokë i shkon,
Kapuçi ynë një krenari,
Dhunti e të shtrenjtave,
Kosovë e Shqipëri.

KU MBETËN E KU JANË

Vëllezërit e motrat tona,
Ku mbetën e ku janë?!
Hallakatur globit anembanë.
I dëgjoj se si më vijnë,
Ofshamën aq pranë ua ndiej,
Piskamën e zogjve të vetmuar ua dëgjoj,
Nga anembanë botës.

Kthehemi në vendin tonë,
Vijmë te vatani ynë,
Piskama jonë i ngazëllen.
Jemi në vendin tonë,
Me piskamë i thërrasim:
O motra! O vëllezër,
A jeni? Ku jeni vallë?!
Fluturimthi vijnë drejt nesh,
Plot hare dhe thonë: “Këtu jemi”.
Shqiponjat te foletë e tyre
Kthehen sërish e sërish.

ASHTU SI ISHTE MË PARË

Kurrë mos u ktheftë më prapë,
Kohë e plagëve dhe e vdekjeve që na dhanë
Dhe tani dhimbjet e vjetra pikë-pikë kullojnë,
Dëshmi varret e dëshmorëve,
Kujtimet e mpiksura t'i ruajmë gjallë.
Historia argumentet lexon
Si ishte Dardania më parë?
- Me Iliridën njësh të pandarë.
Shpirti i dëshmorëve
Lart atje në qiell na frymëzon,
Do të vijë dhe ajo ditë e bekuar
Kur atdheut tonë të bashkuar
Do t'i buzëqeshë Zoti:
Kurrë më, ashtu si ishte më parë!
Gjithmonë bashkë!

KURRË S'I HARROJMË

Knoma kangën e Shqipnisë
T'i kujtoj ata që s'janë,
M'u dogj zemra prej mërzisë
E Shqipninë ma nuk e panë.
Tragjikisht i vranë...
E ata erdhën prapë,
Dhe përsëri i vranë
Ende zi mbajmë.

E keqja vërsulej prapë
Si shpirti i tyre me t'njëjtat rroba të zeza.
Vinin e ne nuk i shihnim,
Asnjë fjalë s'bisedonin
Rrotull shtëpisë si qentë shkonin,
Në qafë iu binin luleve të kopshtit.
S'dinim se kush janë,
Shpirti i tyre mes nesh ishte
Në lulet e kopshtit vendin e kishte.

Zhurmohej, njerëz pa fjalë t'heshtur ishin,
Dëgjohej oshëtimë, s'dinim kush janë.
Sa herë që dëgjonim ofshamë
Kur dilnim matanë zjarr e piskamë
Ata shkonin e ne s'i kuptonim.

Fshatçe njerëzit kuvendonin,
Këngët e tyre i këndonin,
Për ta gjithë jetën bisedonim.
Ulur mbi gurë, mur e shkëmb
Zëri i grave, fëmijëve e burrave,
Përrjetohej thellë e dëgjohej
Nga vendi ngriheshin menjëherë,
Humbshin sikur nuk kanë qenë.
“Jemi Ilira, jemi Teuta,
Jemi të rritur nëpër luftëra,
Gjithë shqiptarët kudo janë,
Nuk kanë tjetër veç një nanë¹”
Kur u zgjova, me javë s’bisedova,
Ata kishin mall për vendin që lanë,
Ëndërronin të ktheheshin si më parë.
Kjo qenkësh jeta, ndokush thotë
E tjetri s’mund të bisedojë,
Edhe pse malli e ka marrë,
Përmallimi zemrën ia thërmoi.

¹ Marrë nga një këngë e njohur shqiptare.

Shkojnë e vijnë këtu n'mjerim,
Këta janë bijat dhe bijtë tanë,
Gjithë jetën i kemi në mendje
Dhe kurrë s'i harrojmë...
“Knoma kangën kosovare,
Nana shumë ka pas dëshirë
Për krejt zemrat atdhetare,
Që s'e panë Kosovën e lirë”.

BISEDË ME FAIK KONICËN

Në mendje i kam fjalët e vyera
Të shqiptarëve të mëdhenj,
Nga Naimi e deri te Faiku.

Konicën e kam në mur
Mendjendrituri që shpërthente si Vezuv.
Nga zemra nxori dertet e Arbërisë.

Sa herë e çel derën e shtëpisë,
Sytë thellë m'i ngul meteori ynë,
E në bisedë ritualin hyj me të:

O shpirt i florinjte mendjendritur,
Fjalët e tua të pamatshme me karatë,
I thonë shporru dhimbjes sime.

Ti je dhimbja lotit në gjuhën shqipe
Dashuria jote për shqiptarët e pamatë,
Magjia e mendimeve të tua
Na magjeps, si dje, si sot, e përherë!

Pas Perëndisë e Gjergjit tonë,
Para të cilëve përkulemi gjithmonë,
Edhe ti je drita e t'voglës botës sonë,
O Faik Konica, o bej, qofsh i bekuar,
Që atdheun tonë
E deshe të bashkuar!

SHEKULLI I PAJTIMIT

Koha për pajtim, o miku im,
Ka rrugën e vet të pakthim.
Miku m'qorton për hallet e veta,
Një përgjigje si askushi dot s'ia gjeta.

Nëse vazhdoj t'mos t'i përgjigjem,
Mbase me tjetërkënd do të grindem.
Po që se nuk të përgjigjem ty
S'e gjej dot askund, tënden mirësi.

Koha rrjedh si lumë e nuk ndalet
Njeriu përgjigjet që të jetë i drejtë.
Njeriu është një "qen i tërbuar"
Kur luan mendsh, nxjerr "raketat" për të luftuar.
S'e ndal kush ta helmojë qiellin, tokën e ajrin.
Njerëzit çmeritën e vajtojnë të trishtuar
Qentë e tërbuar stërviten, për të luftuar.

Çfarë ndodh në këtë shekull të ngatërruar?
Njerëzia në demonstrata apelon.
Lufta në këtë shekull njerëzinë e dëmton
Mbajnë mend Hiroshimën e Nagasakën
Bishat e tërbuara luftën lavdërojnë
Me raketat në qiell që i lëshojnë.
Ligësia e vdekja, hare bëjnë në planetin tonë.

Këto janë disa udhëheqës, ushtarë të tërbuar,
Planetin tonë duan ta shkatërrojnë
Njerëzimin ta vrasin e ta likuidojnë.
Njerëzia del në rrugë të demonstrojë
Shkon nëpër faltore, t'i luten Zotit, të shpëtojë.

Zoti ka fuqi luftën ta ndalojë,
Vallë, neve kush do të na shpëtojë?!
Qenve të tërbuar kush u jep fuqi?!

Planetin tonë ta bëjnë pluhur e hi,
Zotin, madhështinë e tij ta dëshpërojnë,
Njerëzinë ta zhdukim e tokën ta helmojnë.

Tani luten në Kishë e Xhami
Në rrugë e në shtëpi, n'tubime e në varfëri.
Njerëzimi s'di ku shkon e s'di ku rri.
Zoti ka mëshirë për njerëzimin
Kiameti na ka hyrë në shpirt e shtëpi!
Maskarenjtë pas lekut e vrasin njëri-tjetrin,
Dhe trazohet drita e s' duket askund diell.
Raketat për njeriun fluturojnë si korbat në qiell.

Kemi shpresë se do t'iu dalim para qenieve të tërbuar.
Qiellin tonë të mrekullueshëm për të mos e helmuar.
Njerëzinë mos ta zhdukim e shkatërrojnë
Njerëzia rrinë me ankth duke u lutur

Sepse vetveten kësisoj e tërbojnë
Kim Jong Unët*, Trumpët*, e tërbuar të ndalen në këtë botë,
Njerëzinë mos ta djegin me zjarr e barot.

Qen e tërbuar, Perëndia i mallkoftë,
Që njerëzinë janë duke helmuar.
Raketat do t'ju kthehen ne vendin tuaj!
Botën lere ashtu siç është, mos helmo njerëzinë
Lëre të qetë në vazhden e vet se Zoti të vret!
O qen të tërbuar, mos luani me zjarrin,
Se do të digjeni me raketat tuaja n'mes të pazarit!...

Kim Jong Un dhe Trump, respektivisht Presidentë të Republikës Popullore të Koresë të Veriut e të SHBA-së, të cilët për një periudhë të gjatë kohe vringëllinë armët dhe ia mpakën frymën njerëzimit për një luftë bërthamore, derisa u arrit qëllimi për denuklearizimin e Koresë së Veriut. Pas përplasjes analoge në mes të BS-së dhe të SHBA-së në fillim të viteve '60 të shekullit të kaluar për armatimin rus në Kubë, që për pak e çoi botën në një luftë bërthamore, rasti i viteve 2017-2018 ishte i dyti për sa i takon rrezikshmërisë së zhdukjes së planetit. Le të shpresojmë të jetë i fundit! Mjaft luftëra ka parë njerëzimi!

VLERAT E ILIRISË

Kjo tokë e Ilirisë sot a nesër...
Do të bëhet e rumbullakët
Kosovë e Shqipëri
Dardani e Arbëri!...

Mbani mend, o njerëzi!
Ora kambanon për ne,
Sa shumë kërkohet nga ne!
Shqipërinë e Kosovën
Dhe krejt trojet tona,
T'i duam, t'i adhurojmë
E t'i ndihmojmë!

Për të mirën e shqiptarëve
Popull i zgjuar e human,
Njerëz të shenjtë gjithandej
Ku janë në rruzullin tokësor.

Me gjuhën tonë të lashtë e të shenjtë
E bukur, e rrjedhshme dhe e ëmbël
E veçantë ndër gjuhë t'botës,
Me para dhe prapashtesa.

Sjellja dhe mirësia të dallon,
Për miqësinë e shpirtin që posedon.
Kushdo të ka zili e të dëgjon...

HIJET E FJALËVE

Era lëviz gjethet,
Hija gjetheve ëndërron,
Rënien nga lisat e gjatë
Të verdhë e të gjelbër.
Gjethet bien në tokë,
Vendin aty e kanë si shtrat,
Shushurimat i dëgjon,
Gjethet fëshfërijnë teksa lëkunden
Strehuar mes gjelbërimeve
Dhe gurëve të tyre,
Në vatan duke humbur.

Hijet e fjalëve na lëndojë
Porsi gjethet kur vajtojnë
Ato ndihen si zërat
E djemve t'braktisur
Kur varrosin nënën a babanë,
Motrën apo vëllamë,
A trimat që u flijuan për vatan.

Muhabeti zhytet n'zgakellat e tokës,
Hyn e del labirinteve të kohës.
Dhe dalin në anën tjetër të botës së lirë,
Yjet lidhin qiellin me tokën
Dritë lëshojnë,
Për të nesërmen mendojnë,
Fusha e gjerë zë nuk bën,
Mali shungullon
Dhe gjethet që vyshken
Tokës qetë e pa zhurmë i lëshon.

Era dherave tjera i dërgon,
Shungullima të duket
Si anije kozmike, mbi ne fluturon,
Drejt qiellit mbi kolibet
E staneve ku bagëtitë e njerëzia
Jeton dhe të tashmen e kultivon.
Shungullimën e anijes kozmike
Bjeshka veshëngritur e dëgjon
Nga thellësia e detit e tokës
Mbi njerëzinë fluturon.

Të dëgjojmë këngët e shpirtit tonë,
Buçitjen e valëve që rrëshqasin,
Me ritëm të pandalshëm shungullojnë
Valë pas vale vezullimi ndriçon.
Si një pemë kur çel e lulëzon,
Muzgut që bie, frymëzimi të kaplon,
Zëri i shpirtërave njerëzorë, t'stimulon.
Dervish Shaqa, shekujt i përjetëson,
Rrugët e bardha t'mërgimit
Me përmallim e trimëri na i shtron,
Shqiptarizmit urtinë ia tregon
Me moral e ideale t'larta na pasuron.

DISA HERË DAL NË DRITARE

Disa herë dal e shoh në dritare,
Rrugës shoh një gaztore,
Vrullthi vrapoj te kopshti
T'ia dhuroj një tufë lule
Me aromë pranverore.

I lumtur jam
Kur kam e s'kam,
Sa herë dal në oborr
E më pastaj në rrugë
Gaztoren ta takoj,
Lulet t'ia dhuroj.

Sa herë shkoj
Te lumi me zall,
Nga dëshpërimi
Mbushem me vaj'.

Në lumë njerëzia
Banjë s'mund të bëjë,
Uji i zi si katran
I braktisur anembanë
Mbeturinat e mbulojnë.
Si anakondë e gjallë lëvrin
Mjegulla e zezë,
Mbi zallin tonë
Duket si lojë me plojë.

Shpeshherë mendoj për njerëzinë,
Nga vdekja s'mund të shpëtojnë,
Disa herë nga një vjershë ua kushtoj,
Të ngrihen, vdekjen ta dëbojnë.

Të hapur në krah,
Na kosit e na bën bar e hi.
Herë pas here them si të iki?!
Tragjedi e ndotjes na mbyti.

Herë pas here
Mjegulla na mbulon,
E shtrirë në tokën
Mbuluar me bar e kashtë
Medet, atdheun im i lashtë!

Edhe një stinë sa erdhi
Pa lule pranvere, vere e vjeshte,
Shpatullat s'mund t'i lëviznin
Nga dheu që i kish mbuluar,
E mjegulla tinëzare,
Nga Sërmnova deri në Konjare,
Shtratin ua kishte shtruar.

ÇKA MBETI PREJ NESH?

Çka mbeti prej nesh
Nga kavaleritë e ditëve memece,
Që me fodullëk kremtonin
Betejat tona të humbura,
Dhe kur shpërthenim nga mllefi
Si do balona të mbushur
Me ajrin e fitimtarëve tanë.
E, çka mbeti nga trembjet tona
Që i braktisëm hijet?!
Pasi kjo natë u rikthye tinëzisht
Dhe në mëngjes sërish u zgjuam.
Fshehur në gjumin e tyre
Që me dashamirësi menduan;
Nëse jemi pasardhësit e trimërisë.,
Nëpër korridore të bardhë çapëlojmë,
Duke përjashtuar çdo kohë
Ngase na i fshinë ëndrrat
Në kohën kur dremisnim
Dhe në kufirin e zgjimit.
Mendjelehtë e matnim
Njëri-tjetrin
Madje dhe veten tonë.
Çka mbeti prej nesh?!

POETI SHKOI NË AMSHIM

Qarku djallëzor, fuqi e madhe
Mendim i pavarur i ngatrrueshmërisë.
Poeti shkoi në amshim shumë kohë
Para se ta mbërthente vdekja.
Mbarimi i huas ia shënoi çdo fjalë
Vetëm zemrat e proshkëta
E ngacmuan urimin,
Duke i ngritur statujë
Lumturisë së palumtur.

JAM JEHONË E PËRJETSHME

Vetëm prekje fluide jam,
Ngrohtësia e dorës në fytyrën tënde.
Kokrra rëre në poret e trupit tënd
Nëse në banjën e diellit po shtrihesh.

Fije e përlotur, kullosa jam:
I gjunjëzuar shputën që ma shkel
Ajër jam që e thith dhe e nxjerr.
Mua më kujton kur për ajër je e etur
Jehonë e përjetshme e hapave të tu jam,
Nëse nuk çapëlon, mbaron qenia e jetës sime.

Akrepi tregues i orës jam
Që të tejkalon për të arritur nga e prapa.
Dritare e hapur jam, agime.

Dëborë që degdiset çdo vit jam,
Që të nënshtrohem.
Hëna - simbol i ftohtë i lirisë.

TROJET E MUNGESËS

Elegjia e paskajshmërisë,
E ritmit të pritjes,
E ngjyros ikonën
Më besnike të botës.

Falë kënaqësisë vullnetmirë,
Dehje shpirtërore i përgëzuar
Luciditet hyjnor,
Dhe përsëri përgëzim
Që t'i prek të gjitha gjestet
Është një vuajtje e vërtetë
Me mundimet më të mira.

Në afërsinë time më lënë
E më çlirojnë nga lumturia
Që gulçiste në trojet e mungesës.